



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2424, datë 27.02.2014

Për

“Miratimin e kryerjes së procesit të këshillimit publik “Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave 1900-1980 MHz, 2110-2170 MHz (IMT)”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

- | | | |
|----------------|------------|---------|
| 1. Z. Piro | Xhixho | Kryetar |
| 2. Z. Alban | Karapici | Anëtar |
| 3. Znj. Alketa | Mukavelati | Anëtar |
| 4. Z. Benon | Paloka | Anëtar |
| 5. Znj. Zamira | Nurçe | Anëtar |

dhe sekretare Znj.Iris Xhanaj, në mbledhjen e datës 27.02.2014, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Miratimin e kryerjes së procesit të këshillimit publik “Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave 1900-1980 MHz, 2110-2170 MHz (IMT)”.

BAZA LIGJORE:

1. Neni 127, 128 i Ligjit Nr. 8485, date 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative”.
2. Pika 2 dhe 4 e nenit 5, shkronja g) dhe gj) të nenit 8, pika 2 e nenit 65, neni 66 dhe neni 68 të ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 9918*), i ndryshuar;
3. Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 466, datë 27.2.2013 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave”.

4. Shkresa e Ministrit nr. 207/1Prot. datë 14.2.2014, si përgjigje e propozimit të AKEP, "Kërkesë për propozim për dhënien në përdorim të frekuencave në brezat 1900-1980 MHz (IMT)".

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor si më poshtë:

- Relacioni përkatës;
- Projektvendimi i KD i formatuar dhe arsyetuar;
- Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

- Shkresa e Ministrit nr. 207/1Prot. datë 14.2.2014, vjen si përgjigje e shkresës së AKEP "Kërkesë për propozim për dhënien në përdorim të frekuencave në brezat 1900-1980 MHz, 2110-2170 MHz (IMT)".
- Ministri, bazuar në kompetencat ligjore pika 2 dhe 4 e nenit 5 dhe neni 68 të ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë" (*ligji nr. 9918*), i ndryshuar, propozon shqyrtimin e mundësisë teknike për dhënien e më shumë se një të drejte përdorimi dhe në këtë kuadër vlerësimin ekonomik në përputhje me praktikat më të mira europiane.
- Dokumentacioni për "**Miratimin e kryerjes së procesit të këshillimit publik "Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave 1900-1980 MHz, 2110-2170 MHz (IMT)"**" është përgatitur në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar ne pikën 1 të nenit 114, pikën 1 të nenit 115 si dhe në nenin 68 të ligjit 9918, i ndryshuar,

V E N D O S:

1. Të miratojë kryerjen e procesit të këshillimit publik "Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave 1900-1980 MHz, 2110-2170 MHz (IMT)";
2. Dokumentat e këshillimit publik "Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave 1900-1980 MHz, 2110-2170 MHz (IMT)" të kenë si objekt:
 - propozimin e ndarjes së këtij brezi (2x15 MHz spektër i çiftuar 1965-1980 - çiftuar me 2155-2170 dhe 5 MHz spektër i paçiftuar 1915-

1920 MHz) për të mundësuar dhënien e më shumë se një të drejtë përdorimi,

- bazuar mbi këtë propozim të kërkohet edhe vlera që ofrojnë sipërmarrësit e interesuar për të drejtë përdorimi.

3. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit www.akep.al ditën e miratimit të tij.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:

1. **Alban KARAPICI** _____
2. **Alketa MUKAVELATI** _____
3. **Benon PALOKA** _____
4. **Zamira NURÇE** _____